



Politika e privatësisë e Apple

Politika e privatësisë e Apple përshkruan mënyrën e mbledhjes, përdorimit dhe ndarjes së të dhënave tuaja personale nga Apple.

Përditësuar më 31 mars 2024



Përveç politikës së privatësisë, ne ofrojmë informacione për të dhënat dhe privatësinë të integruara në produktet tona dhe funksione të caktuara që kërkojnë përdorimin e të dhënave tuaja. Këto informacione specifike për produktin shoqërohen nga ikona jonë për të dhënat dhe privatësinë.

Ju do të keni mundësinë t'i rishikoni informacionet specifike për produktin përpara se t'i përdorni këto funksione. Gjithashtu, këto informacione mund t'i shikoni në çdo kohë te cilësimet lidhur me ato funksione dhe/ose në linjë te apple.com/legal/privacy.

Kushtojini pak çaste njohjes së praktikave tona të privatësisë, të cilat mund t'i gjeni në titujt e mëposhtëm, dhe [na kontaktoni](#) nëse keni pyetje.

[Politika e privatësisë së aplikacioneve të Apple për studimin e shëndetit](#)

[Çfarë janë të dhënat personale në Apple?](#)
[Të drejtat tuaja të privatësisë në Apple](#)
[Të dhënat personale që Apple mbledh nga ju](#)
[Të dhënat personale që Apple merr nga burime të tjera](#)
[Përdorimi i të dhënave personale nga Apple](#)
[Ndarja e të dhënave personale nga Apple](#)
[Mbrojtja e të dhënave personale në Apple](#)
[Fëmijët dhe të dhënat personale](#)
[Kukit dhe teknologjitë e tjera](#)
[Transferimi i të dhënave personale ndërmjet shteteve](#)
[Përkushtimi i të gjithë kompanisë sonë për privatësinë tuaj](#)
[Pyetje rreth privatësisë](#)

Çfarë janë të dhënat personale në Apple?

Në Apple, ne besojmë fort tek të drejtat themelore të privatësisë - dhe se ato të drejta themelore nuk duhet të ndryshojnë në varësi të vendit ku jetoni. **Për këtë arsye, ne i trajtojmë të gjitha të dhënat në lidhje me një individ të identifikuar apo të identifikueshëm ose që janë lidhur ose mund të lidhen me të nga Apple si "të dhëna personale", pavarësisht se ku jeton individ.** Kjo do të thotë se të dhënat që ju identifikojnë drejtpërdrejt - si p.sh. emri juaj - janë të dhëna personale dhe gjithashtu të dhënat që nuk ju identifikojnë drejtpërdrejt, por që mund të përdoren në mënyrë të arsyeshme për t'ju identifikuar - si p.sh. numri i serisë së pajisjes suaj - janë të dhëna personale. Të dhënat e bashkuara konsiderohen të dhëna jopersonale për qëllimet e kësaj Politike të privatësisë.

Kjo politikë e privatësisë trajton mënyrën se si i trajton [Apple ose një kompani filiale e Apple](#) (në tërësi, "Apple") të dhënat personale, si kur ndërveproni me ne në uebsajtet tona, përmes aplikacioneve të Apple (si p.sh. Apple Music ose Wallet), ashtu dhe personalisht (duke përfshirë përmes telefonit ose kur vizitoni një Apple Store). Gjithashtu, Apple mund të lidhet me palët e treta për shërbimet tona ose t'i bëjë aplikacionet e palëve të treta të disponueshme për shkarkim në dyqanin tonë App Store. Politika e privatësisë e Apple nuk zbatohet për mënyrën e përkufizimit të të dhënave personale apo të përdorimit të tyre nga palët e treta. Ju inkurajojmë që të lexoni politikat e tyre të privatësisë dhe të njihni të drejtat tuaja të privatësisë përpara se të ndërveproni me to.

Të drejtat tuaja të privatësisë në Apple

Në Apple, ne respektojmë mundësinë tuaj për të njohur, shfrytëzuar, korrigjuar, transferuar, kufizuar përpunimin dhe për të fshirë të dhënat tuaja personale. Këto të drejta privatësie i kemi përfshirë në bazën tonë globale të klientëve dhe, nëse zgjidhni të ushtroni këto të drejta të privatësisë, ju gëzoni të drejtën të mos trajtoheni në mënyrë diskriminuese dhe të mos merrni një nivel më të ulët shërbimi nga Apple. Kur ju kërkohet të jepni pëlqim për përpunimin e të dhënave tuaja personale nga Apple, keni të drejtën ta tërhiqni pëlqimin në çdo kohë.

Për të ushtruar të drejtat dhe zgjedhjet tuaja për privatësinë, duke përfshirë këtu rastin kur një ofrues i shërbimeve të palës së tretë vepron në emër të Apple, vizitoni faqen e të dhënave dhe privatësisë së Apple në privacy.apple.com për Apple ose shazam.com/privacy për Shazam. Për të ndihmuar në ruajtjen e sigurisë së të dhënave tuaja personale, duhet të hyni në llogari dhe identiteti juaj do të verifikohet. Nëse dëshironi të merrni një kopje të të dhënave personale që nuk është aktualisht e disponueshme nga privacy.apple.com, mund të bëni një kërkesë në apple.com/legal/privacy/contact. Keni gjithashtu të drejtën të depozitoni në ankesë në rregullatorin përkatës.

Mund të ketë raste kur ne nuk mund ta miratojmë kërkesën tuaj - për shembull, kur na kërkonit të fshijmë të dhënat e transaksionit tuaj dhe Apple ka detyrimin ligjor që të mbajë të dhënat e atij transaksioni për të qenë në përputhje me ligjin. Ne mund ta refuzojmë një kërkesë edhe në rastin kur një veprim i tillë do të cenonte përdorimin legjitim të të dhënave nga ana jonë për qëllime të sigurisë dhe parandalimit të mashtrimit, si p.sh. kur kërkonit fshirjen e një llogarie që është duke u hetuar për arsye sigurie. Arsye të tjera për të cilat kërkesa juaj mund të mohohet përfshijnë rastet kur ajo rrezikon privatësinë e të tjerëve, është e pavlerë apo shqetësuese ose është jashtëzakonisht jopraktike ose e paarsyeshme.

Nëse banoni në Kaliforni dhe nuk keni akses në faqen e të dhënave dhe të privatësisë së Apple, ju ose agjenti juaj i autorizuar mund të bëni një kërkesë në apple.com/legal/privacy/contact ose duke telefonuar në nr. 1-800-275-2273.

Për më shumë informacione mbi ushtrimin e të drejtave tuaja, vizitoni support.apple.com/102283.

Të dhënat personale që Apple mbledh nga ju

Në Apple, ne besojmë se mund t'ju ofrojmë produkte dhe privatësi të shkëlqyer. Kjo do të thotë se përpiqemi të **mbledhim vetëm të dhënat personale që na nevojiten**. Të dhënat personale që mbledh Apple varen nga mënyra e ndërveprimit tuaj me Apple. Përshkrimet se si i trajton Apple të dhënat personale për shërbime të caktuara individuale janë në dispozicion në apple.com/legal/privacy/data.

Kur krijoni një ID të Apple, aplikoni për kredi tregtare, blini dhe/ose aktivizoni një produkt ose pajisje, shkarkoni një përditësim softueri, regjistroheni për një mësim në një Apple Store, lidheni në shërbimet tona, na kontaktoni (duke përfshirë përmes medieve sociale), merrni pjesë në një anketë në linjë ose ndërveproni në mënyrë tjetër me Apple, ne mund të mbledhim një sërë informacionesh, duke përfshirë:

- **Informacionet rreth llogarisë.** ID-në tuaj të Apple dhe detaje të lidhura me llogarinë, duke përfshirë adresën e emailit, pajisjet e regjistruara, statusin e llogarisë dhe moshën
- **Informacionet rreth pajisjes.** Të dhënat identifikuese të pajisjes suaj, si p.sh. numrin e serisë së pajisjes, ose rreth pajisjes suaj, si p.sh. llojin e shfletuesit
- **Informacionet e kontaktit.** Të dhënat e tilla si, emri, adresa e emailit, adresa fizike, numri i telefonit ose informacione të tjera të kontaktit
- **Informacionet rreth pagesës.** Të dhënat rreth adresës suaj të faturimit dhe mënyrës së pagesës, të tilla si të dhënat bankare, informacionet rreth kartës së kreditit, kartës së debiti ose një karte tjetër pagese
- **Informacionet rreth transaksioneve.** Të dhënat për blerjet e produkteve dhe shërbimeve të Apple ose për transaksionet e lehtësuara nga Apple, duke përfshirë blerjet në platformat e Apple
- **Informacionet rreth parandalimit të mashtrimeve.** Të dhënat e përdorura për të ndihmuar në identifikimin dhe parandalimin e mashtrimeve, duke përfshirë rezultatin në pikë të besueshmërisë së pajisjes

- **Të dhënat e përdorimit.** Të dhëna rreth aktivitetit dhe përdorimit të produkteve tona nga ana juaj, si prezantimet e aplikacioneve në shërbimet tona, duke përfshirë historikun e shfletimit; historikun e kërkimit; ndërveprimin me produktin; të dhëna rreth ndërprerjes dhe performancës dhe të dhëna të tjera diagnostikuese; si dhe të dhëna të tjera të përdorimit
- **Informacionet e vendndodhjes.** Vendndodhjen e saktë vetëm për të mbështetur shërbimet e tilla si "Find My" ose kur bini dakord për shërbime specifike rajonale dhe vendndodhjen e përgjithshme
- **Informacionet shëndetësore.** Të dhënat për gjendjen shëndetësore të një individi, duke përfshirë të dhënat për gjendjen ose shëndetin fizik ose mendor. Të dhënat personale shëndetësore përfshijnë gjithashtu të dhënat që mund të përdoren për të nxjerrë përfundime ose për të zbuluar gjendjen shëndetësore të një individi. Nëse merrni pjesë në një studim duke përdorur një aplikacion të Apple për studimin e shëndetit, politika që rregullon privatësinë e të dhënave tuaja personale përshkruhet te [Politika e privatësisë së aplikacioneve të Apple për studimin e shëndetit](#).
- **Informacionet rreth formës fizike.** Detajet rreth formës suaj fizike dhe informacionet për ushtrimet, kur zgjidhni t'i ndani këto të dhëna
- **Informacionet financiare.** Detajet që përfshijnë informacionet rreth pagës, të ardhurave dhe pasurive, kur mblidhen, dhe informacionet për ofertat financiare të markës Apple
- **Të dhënat e dokumentit të identifikimit të lëshuar nga qeveria.** Në disa juridiksione, mund t'ju kërkojmë në rrethana të caktuara një dokument identifikimi të lëshuar nga qeveria, duke përfshirë rastet kur konfiguroni një llogari pa tel dhe kur aktivizoni pajisjen, për qëllimet e zgjatjes së kredisë tregtare, menaxhimit të rezervimeve ose siç kërkohet nga ligji
- **Informacione të tjera që na jepni.** Detajet e tilla si përmbajtja e komunikimeve tuaja me Apple, duke përfshirë ndërveprimet me mbështetjen e klientit dhe kontaktet përmes kanaleve të mediave sociale

Ju nuk jeni të detyruar të na i jepni të dhënat personale që ju kërkojmë. Megjithatë, nëse zgjidhni të mos e bëni këtë, në shumë raste nuk do të jemi në gjendje t'ju ofrojmë produktet ose shërbimet tona apo t'u përgjigjemi kërkesave që mund të keni.

Të dhënat personale që Apple merr nga burime të tjera

Apple mund të marrë të dhëna personale rreth jush nga **individë** të tjerë, nga biznese ose palë të treta që veprojnë **sipas udhëzimeve tuaja**, nga **partnerët** tanë që punojnë me ne për të ofruar produktet dhe shërbimet tona dhe që na ndihmojnë në ruajtjen e sigurisë dhe parandalimin e mashtrimeve, si dhe nga burime të tjera të ligjshme.

- **Individët.** Apple mund të mbledhë të dhëna rreth jush nga individë të tjerë - për shembull, nëse ai individ ju ka dërguar një produkt ose kartë dhuratë, ju ka ftuar të merrni pjesë në një shërbim ose forum të Apple ose ka ndarë përmbajtje me ju.
- **Sipas udhëzimeve tuaja.** Ju mund të udhëzoni individë të tjerë ose palë të treta për të ndarë të dhëna me Apple. Për shembull, mund të udhëzoni operatorin tuaj të shërbimit celular që të ndajë me Apple të dhënat e llogarisë suaj të operatorit për qëllime të aktivizimit të llogarisë, ose mund të udhëzoni programin e besueshmërisë që të ndajë informacione rreth pjesëmarrjes suaj, në mënyrë që të mund të fitoni shpërblime për blerjet përmes Apple.
- **Partnerët e Apple.** Ne mund të konfirmojmë gjithashtu informacionet që na jepni - për shembull kur krijoni një ID të Apple, me një palë të tretë për qëllime të sigurisë dhe për parandalimin e mashtrimit.

Për qëllime zhvillimi dhe kërkimi, ne mund të përdorim grupe të të dhënave si p.sh. ato që përfshijnë imazhe, zëra ose të dhëna të tjera që mund të lidhen me një person të identifikueshëm. Kur marrim grupe të tilla të të dhënave, e bëjmë këtë në përputhje me ligjin në fuqi, duke përfshirë përputhjen me ligjin në juridiksionin ku ruhet grupi i të dhënave. Kur përdorim grupe të tilla të të dhënave për kërkim dhe zhvillim, nuk përpiqemi t'i identifikojmë sërish individët që mund të shfaqen aty.

Përdorimi i të dhënave personale nga Apple

Apple i përdor të dhënat personale për të mundësuar shërbimet tona, për të përpunuar transaksionet tuaja, për të komunikuar me ju, për sigurinë dhe parandalimin e mashtrimeve, si dhe për të respektuar ligjin. Të dhënat personale i përdorim edhe për qëllime të tjera, me miratimin tuaj.

Apple i përdor të dhënat tuaja personale vetëm kur kemi një bazë të vlefshme ligjore për ta bërë këtë.

Në varësi të rrethanave, Apple mund të mbështetet në miratimin tuaj ose në faktin që përpunimi nevojitet për përmbushjen e një kontrate me ju, për të mbrojtur interesat tuaja jetike ose interesat jetike të personave të tjerë, ose për të respektuar ligjin. Ne mund t'i përpunojmë të dhënat tuaja personale edhe kur besojmë se kjo është në interesin e të tjerëve apo në interesin tonë legjitim, duke pasur parasysh interesat, të drejtat dhe pritshmëritë tuaja. Informacione të mëtejshme disponohen në informacionet specifike për produktin, të integruara në produktet dhe funksionet tona siç përshkruhet më lart. Nëse keni pyetje rreth bazës ligjore, mund të kontaktoni me përgjegjësin për mbrojtjen e të dhënave në apple.com/legal/privacy/contact.

- **Mundësimi i shërbimeve tona.** Apple mbledh të dhënat personale që janë të nevojshme për të mundësuar shërbimet tona, ku mund të përfshihen të dhënat personale të mbledhura për të përmirësuar ofertat tona, për qëllime të brendshme, të tilla si auditimi ose analizimi i të dhënave, ose për zgjidhjen e problemeve. Për shembull, nëse dëshironi të përdorni një këngë përmes një abonimi në Apple Music, ne mbledhim të dhëna për këngët që dëgjoni me qëllim që t'ju ofrojmë përmbajtjen e kërkuar si dhe për qëllime të së drejtës së autorit.
- **Përpunimi i transaksioneve tuaja.** Për të përpunuar transaksionet, Apple duhet të mbledhë të dhëna të tilla si emri juaj dhe informacionet për blerjen dhe pagesën.
- **Komunikimi me ju.** Për t'iu përgjigjur komunikimeve, për t'ju kontaktuar në lidhje me transaksionet ose llogarinë tuaj, për të tregtuar produktet dhe shërbimet tona, për të ofruar informacione të tjera të rëndësishme ose për të kërkuar informacione ose komente. Herë pas here, ne mund t'i përdorim të dhënat tuaja personale për të dërguar njoftime të rëndësishme, të tilla si komunikimet rreth blerjeve dhe ndryshimeve në kushtet, afatet dhe politikat tona. Duke qenë se këto informacione janë të rëndësishme për ndërveprimin tuaj me Apple, nuk mund të refuzoni marrjen e këtyre njoftimeve të rëndësishme.
- **Siguria dhe parandalimi i mashtrimeve.** Për të mbrojtur individët, punonjësit dhe Apple dhe për të parandaluar humbjen dhe mashtrimet, duke përfshirë mbrojtjen e individëve, punonjësve dhe Apple në përfitim të të gjithë përdoruesve tanë, si dhe për të shqyrtuar paraprakisht ose për të skanuar përmbajtjet e ngarkuara për përmbajtje që mund të jenë të paligjshme, duke përfshirë dhe materialet e shfrytëzimit seksual të fëmijëve.
- **Të dhënat personale të përdorura për personalizimin.** Nëse zgjidhni të personalizoni shërbimet ose komunikimet tuaja kur këto opsione janë në dispozicion, Apple do të përdorë informacionet që mbledhim, në mënyrë që t'ju ofrojmë ato shërbime ose komunikime të personalizuar. Mund të mësoni më shumë rreth mënyrës se si i përdorim shërbimet përkatëse informacionet për të personalizuar përvojën tuaj duke rishikuar informacionet e privatësisë të paraqitura kur përdorni për herë të parë një shërbim që kërkon të përdorë të dhënat tuaja personale. Ne i bëjmë këto informacione të lehta për t'u gjetur duke i paraqitur

me ikonën tonë të të dhënave dhe privatësisë; ato janë gjithashtu në dispozicion në çdo kohë në pajisjen tuaj Apple dhe në linjë në apple.com/legal/privacy/data.

- **Respektimi i ligjit.** Për të respektuar ligjin e zbatueshëm - për shembull, për të përmbushur detyrimet tatimore ose të raportimit ose për të respektuar një kërkesë të ligjshme shtetërore.

Apple nuk përdor algoritme apo profilizim për marrjen e vendimeve me ndikim të konsiderueshëm ndaj jush, pa mundësinë e rishikimit nga njeriu. Apple gjithashtu nuk përdor apo zbulon të dhëna personale delikate për asnjë qëllim për të cilin një përdoruesi do t'i duhet të ushtrojë një të drejtë për të kufizuar përpunimin, sipas ligjit të Kalifornisë.

Apple i ruan të dhënat personale vetëm për sa kohë që nevojiten për përmbushjen e qëllimeve për të cilat janë mbledhur, duke përfshirë siç përshkruhet në këtë politikë të privatësisë ose në njoftimet tona të privatësisë për shërbimet përkatëse ose siç kërkohet nga ligji. Ne do t'i mbajmë

të dhënat tuaja personale për periudhën e nevojshme për përmbushjen e qëllimeve të përcaktuara në këtë Politikë të privatësisë dhe në njoftimet tona të privatësisë për shërbimet përkatëse. Kur vlerësojmë periudhat e mbajtjes, ne fillimisht shqyrtojmë me kujdes nëse nevojitet mbajtja e të dhënave personale të mbledhura dhe, nëse mbajtja është e domosdoshme, përpiqemi t'i mbajmë të dhënat personale për periudhën më të shkurtër të mundshme të lejuar nga ligji.

Ndarja e të dhënave personale nga Apple

Apple mund të ndajë të dhënat personale me **kompanitë filiale të Apple, ofruesit e shërbimeve** që veprojnë për llogarinë tonë, **partnerët tanë, zhvilluesit dhe publikuesit** ose me të tjerë **sipas udhëzimeve tuaja**. Për më tepër, Apple nuk i ndan të dhënat personale me palët e treta për qëllimet e tyre të marketingut.

- **Ofruesit e shërbimeve.** Apple mund të angazhojë palë të treta për të vepruar si ofrues të shërbimeve tona dhe për të kryer detyra të caktuara për llogarinë tonë, si p.sh. përpunimin ose ruajtjen e të dhënave, duke përfshirë të dhënat personale, në lidhje me përdorimin e shërbimeve tona nga ana juaj dhe ofrimin e produkteve për klientët. Ofruesit e shërbimeve të Apple kanë detyrimin që t'i trajtojnë të dhënat personale në përputhje me këtë politikë të privatësisë dhe sipas udhëzimeve tona. Ata nuk mund t'i përdorin të dhënat personale që ndajmë për qëllimet e tyre dhe duhet t'i fshijnë ose t'i kthejnë ato menjëherë pasi të kenë përmbushur kërkesën tonë.
- **Partnerët.** Ndonjëherë, Apple mund të bashkëpunojë me palë të treta për të ofruar shërbime ose oferta të tjera. Për shembull, ofertat financiare të Apple, si Apple Card dhe Apple Cash, ofrohen nga Apple dhe partnerët tanë. Apple u kërkon partnerëve të saj që t'i mbrojnë të dhënat tuaja personale.
- **Zhvilluesit dhe publikuesit nga të cilët merrni një abonim.** Nëse blini një abonim të një pale të tretë nga App Store apo nga brenda Apple News, ne krijojmë një ID të abonentit që është unike për ju dhe zhvilluesin ose publikuesin. ID-ja e abonentit mund të përdoret për t'i dërguar zhvilluesit ose publikuesit raporte që përfshijnë informacione rreth abonimit që bletë dhe vendbanimin tuaj. Nëse i anuloni të gjitha abonimet nga një zhvillues ose publikues i caktuar, ID-ja e abonentit do të rivendoset pas 180 ditësh nëse nuk abonoheni sërish. Ky informacion iu jepet zhvilluesve ose publikuesve, në mënyrë që ata të kuptojnë mbarëvajtjen e abonimeve të tyre.
- **Të tjera.** Apple mund t'i ndajë të dhënat personale me të tjerët me udhëzimin ose miratimin tuaj, si p.sh. kur ndajmë informacione me operatorin tuaj telefonik për të aktivizuar llogarinë tuaj. Mund të zbulojmë gjithashtu informacione rreth jush nëse përcaktojmë se zbulimi është i nevojshëm ose i përshtatshëm për arsye të sigurisë kombëtare, zbatimit të ligjit apo çështjeve të tjera me rëndësi publike. Mund të zbulojmë informacione rreth jush edhe në rastet kur ka baza ligjore për ta bërë këtë, nëse përcaktojmë se zbulimi

nevojitet në mënyrë të arsyeshme për zbatimin e kushteve tona të përgjithshme ose për mbrojtjen e aktiviteteve apo të përdoruesve tanë, ose në rast riorganizimi, shkrirjeje apo shitjeje.

Apple nuk i shet të dhënat tuaja personale, duke përfshirë "shitjen" siç përcaktohet në Nevadë dhe Kaliforni. Apple gjithashtu nuk i "ndan" të dhënat tuaja personale siç përkufizohet ky term në Kaliforni.

Mbrojtja e të dhënave personale në Apple

Në Apple, ne besojmë se privatësia e shkëlqyer bazohet te siguria e shkëlqyer. Ne përdorim masa administrative, teknike dhe fizike për të mbrojtur të dhënat tuaja personale, duke pasur parasysh natyrën dhe përpunimin e të dhënave personale dhe kërcënimet që paraqiten. Ne punojmë vazhdimisht për t'i përmirësuar këto masa, në mënyrë që të ndihmojnë në ruajtjen e sigurisë së të dhënave tuaja personale. Për më shumë informacione, vizitoni udhëzuesin tonë [Siguria e platformës së Apple](#).

Fëmijët dhe të dhënat personale

Apple e kupton rëndësinë e mbrojtjes së të dhënave personale të fëmijëve, ku fëmijë konsiderojmë **individët nën 13 vjeç ose individët në moshën e parashikuar nga ligji në juridiksionin tuaj**. Për këtë arsye, Apple ka vënë në zbatim procese dhe mbrojtje shtesë që ndihmojnë në ruajtjen e sigurisë së të dhënave personale të fëmijëve.

Për të pasur qasje në shërbime të caktuara të Apple, një fëmijë duhet të ketë një ID të Apple për fëmijë. Një ID e Apple për fëmijë mund të krijohet nga **prindi** ose, në rastin e një ID-je të menaxhuar të Apple, nga **institucioni arsimor i fëmijës**.

- **Prindërit.** Për të krijuar një llogari fëmije, prindërit duhet të shqyrtojnë dokumentin [Zbulimi i privatësisë familjare për fëmijët](#), ku përshkruhet se si i trajton Apple të dhënat personale të fëmijëve. Prindërit mund t'i japin Apple një miratim të verifikueshëm prindëror, nëse bien dakord.
- **Institucionet arsimore.** Edhe institucionet arsimore që marrin pjesë në programin e Apple School Manager mund të krijojnë ID të Apple për nxënësit, të quajtura "ID të menaxhuara të Apple". Këtyre shkollave u kërkohet të pranojnë [ID-të e menaxhuara të Apple për zbulimin e informacioneve të nxënësve](#), i cili është i përfshirë si shtojca A në marrëveshjen e Apple School Manager.

Nëse mësojmë se të dhënat personale të një fëmije janë mbledhur pa autorizimin e duhur, ato do të fshihen në momentin më të parë të mundshëm.

Për të ushtruar të drejtat e privatësisë në lidhje me informacionet e fëmijës suaj, vizitoni faqen e të dhënave dhe të privatësisë së Apple në [privacy.apple.com](#) dhe hyni në llogarinë e fëmijës.

Kukit dhe teknologjitë e tjera

Uebfaqet, shërbimet në linjë, aplikacionet ndërvepruese dhe reklamat e Apple mund të përdorin "**kuki**" dhe [teknologji të tjera](#), të tilla si sinjalizuesit e uebit. **Këto teknologji na ndihmojnë të kuptojmë më mirë sjelljen e përdoruesit, duke përfshirë për qëllime të sigurisë dhe të parandalimit të mashtrimit, na tregojnë se cilat pjesë të uebsajteve tona kanë vizituar njerëzit dhe lehtësojnë e vlerësojnë efektivitetin e reklamave dhe kërkimeve në ueb.**

- **Kukit e komunikimeve.** Këto kuki përdoren për të mundësuar trafikun në rrjet drejt dhe nga sistemet e Apple, duke përfshirë për të na ndihmuar për të zbuluar gabimet.

- **Kukit rreptësisht të nevojshme.** Këto kuki caktohen si të domosdoshme për të ofruar një funksion ose shërbim specifik të shfrytëzuar ose të kërkuar nga ju. Për shembull, ato na mundësojnë të shfaqim uebsajtet tona në formatin dhe gjuhën e duhur, të vërtetojmë dhe të verifikojmë transaksionet tuaja dhe të ruajmë përmbajtjet e shportës suaj kur blini në linjë në apple.com.
- **Kuki të tjera.** Këto kuki përdoren për të kuptuar se si ndërveprojnë vizitorët me uebsajtet dhe shërbimet tona në linjë, duke përfshirë ndihmën që të vlerësojmë efektivitetin e reklamave dhe kërkimeve në ueb. Apple i përdor këto kuki edhe për të kujtuar zgjedhjet që bëni ndërsa shfletoni, në mënyrë që të mund t'ju ofrojmë një përvojë të personalizuar.

Nëse parapëlqeni që Apple të mos përdorë kuki, ne ju ofrojmë mënyrat se si të çaktivizoni përdorimin e tyre. Nëse dëshironi t'i çaktivizoni kukit dhe po përdorni shfletuesin Safari, zgjidhni "Blloko të gjitha kukit" te cilësimet e privatësisë së Safari. Nëse përdorni një shfletues tjetër, pyetni ofruesin tuaj të shërbimit për të mësuar se si të çaktivizoni kukit. Disa funksione të uebsajtit të Apple mund të mos jenë në dispozicion nëse çaktivizohen të gjitha kukit.

Përveç kukive, Apple përdor edhe teknologji të tjera që na ndihmojnë të arrijmë objektiva të ngjashme.

Në disa mesazhe emaili që ju dërgon Apple, ne japim një "URL ridrejtuese" që ju lidh me përmbajtjen në uebsajtin e Apple. Kur klikoni në një nga këto URL, ato kalojnë përmes një serveri të veçantë para se të mbërrini në faqen e destinacionit në uebsajtin tonë. Ne e gjurmojmë këtë klikim për të na ndihmuar të përcaktojmë interesin në tema të veçanta dhe të vlerësojmë nëse po komunikojmë me ju në mënyrë efektive. Nëse parapëlqeni të mos gjurmoheni në këtë mënyrë, mos i shtypni lidhjet grafike apo në formë teksti në mesazhet e emailit.

Në përgjithësi, Apple i trajton të dhënat që mbledhim duke përdorur këta kuki dhe teknologjitë e ngjashme si të dhëna jopersonale. Gjithsesi, në masën që adresat e protokollit të internetit (IP) ose identifikues të ngjashëm konsiderohen të dhëna personale nga ligji vendor, ne i trajtojmë këta identifikues edhe si të dhëna personale në ato rajone. Për më tepër, Apple i kombinon ndonjëherë të dhënat jopersonale të mbledhura nga këto teknologji me të dhëna të tjera personale që mban Apple. Kur i kombinojmë të dhënat në këtë mënyrë, ne i trajtojmë të dhënat e kombinuara si të dhëna personale për qëllimet e kësaj politike të privatësisë.

Reklamat që shfaqen nga platforma e reklamimit e Apple mund të shfaqen në aplikacionin App Store, Apple News, Stocks dhe Apple TV në varësi të vendndodhjes suaj. Platforma e reklamimit e Apple nuk ju gjurmon, që do të thotë se nuk i lidh të dhënat e përdoruesit ose të pajisjes të mbledhura nga aplikacionet tona me të dhënat e përdoruesit ose të pajisjes të mbledhura nga palë të treta për reklamim sipas objektivit ose për qëllimet e matjes së reklamimit dhe nuk i ndan të dhënat e përdoruesit ose të pajisjes me ndërmjetësit e të dhënave.

Nëse nuk dëshironi të merrni reklama të personalizuar sipas interesave tuaja nga platforma e reklamimit të Apple, mund të zgjidhni të çaktivizoni Reklamat e personalizuar, gjë e cila do ta përjashtojë ID-në tuaj të Apple nga marrja e këtyre reklamave pavarësisht nga pajisja që po përdorni. Në pajisjen tuaj me iOS, iPadOS ose visionOS, mund t'i çaktivizoni Reklamat e personalizuar duke shkuar te Settings > Privacy & Security > Apple Advertising dhe duke trokitur për të çaktivizuar Personalized Ads. Në pajisjen tuaj Mac mund t'i çaktivizoni Reklamat e personalizuar duke shkuar te System Settings > Privacy & Security > Privacy > Advertising, dhe duke çzgjedhur Personalized Ads. Mund të vazhdoni sërish të shikoni reklama në App Store, Apple News ose Stocks bazuar në kontekstin siç janë kërkesat tuaja të kërkimit apo kanali që po lexoni. Nëse e çaktivizoni Lejo aplikacionet që të kërkojnë të gjurmojnë, aplikacionet e palëve të treta nuk mund të kërkojnë të përdorin Identifikuesin e reklamave, një identifikues jopersonal të ofruar nga sistemi operativ në pajisjen tuaj, për t'ju gjurmuar nëpër aplikacione dhe uebsajte të zotëruara nga kompani të tjera.

Për më shumë informacione rreth reklamimit të ofruar nga Apple dhe privatësisë, vizitoni apple.com/legal/privacy/data/en/apple-advertising.

Transferimi i të dhënave personale ndërmjet shteteve

Produktet dhe shërbimet e ofruara nga Apple ju lidhin me botën. Për ta bërë të mundur këtë, **të dhënat tuaja personale mund të transferohen tek entite në të gjithë botën ose të përdoren nga ato**, duke përfshirë kompanitë filiale të Apple, për të kryer aktivitetet e përpunimit, të tilla si ato të përshkruara në këtë Politikë të privatësisë në lidhje me përdorimin e produkteve dhe shërbimeve tona nga ju. Apple respekton ligjet për transferimin e të dhënave personale ndërmjet vendeve, për të ndihmuar në garantimin e mbrojtjes së të dhënave tuaja kudo që të ndodhen.

Entiteti i Apple që kontrollon të dhënat tuaja personale mund ndryshojë në varësi të vendit ku banoni.

Për shembull, informacionet e Apple Store kontrollohen nga entitetet individuale të shitjes me pakicë në secilin vend dhe të dhënat personale që lidhen me shërbimet e mediave të Apple mund të kontrollohen nga entitete të ndryshme të Apple siç pasqyrohet në kushtet e shërbimit. Nëse nuk banoni në SHBA, të dhënat tuaja personale mund të përpunohen nga Apple Inc. dhe kompani të tjera filiale të Apple në emër të entitetit të Apple që kontrollon të dhënat personale në juridiksionin tuaj. Për shembull, imazhet dhe të dhënat e ngjashme të mbledhura nga Apple anembanë botës për të përmirësuar Apple Maps dhe për të mbështetur funksionin tonë Shiko përreth (Look around), i transferohen Apple Inc. në Kaliforni.

Të dhënat personale në lidhje me individët që banojnë në Zonën Ekonomike Evropiane, Mbretërinë e Bashkuar dhe Zvicër, kontrollohen nga Apple Distribution International Limited në Irlandë. Transferimi ndërkombëtar nga Apple i të dhënave personale të mbledhura në Zonën Ekonomike Evropiane, Mbretërinë e Bashkuar dhe Zvicër, rregullohet nga [Dispozitat kontraktuale standarde](#). Nëse keni pyetje ose dëshironi një kopje të Dispozitave kontraktuale standarde të Apple, mund të na kontaktoni në apple.com/legal/privacy/contact.

Të dhënat personale të mbledhura nga [Apple ose një kompani filial i Apple](#) në mbarë botën, ruhen përgjithësisht nga Apple Inc. në Shtetet e Bashkuara. Pavarësisht se ku ruhen të dhënat tuaja personale, Apple ruan të njëjtin nivel të lartë të mbrojtjes dhe masave mbrojtëse. Transferimi ndërkombëtar nga Apple i të dhënave personale të mbledhura në vendet pjesëmarrëse të Bashkëpunimit Ekonomik Aziatiko-Paqësor (APEC), respekton [Sistemin e Rregullave të Privatësisë Ndërkufitare \(CBPR\) të APEC-së](#) dhe [Sistemin e njohjes së privatësisë për përpunuesit \(PRP\)](#) për transferimin e të dhënave personale. Vendet pjesëmarrëse në sistemet CBPR të APEC-së deri në datën e kësaj politike të privatësisë janë Shtetet e Bashkuara, Australia, Kanadaja, Tajpei Kinez, Japonia, Meksika, Filipinet, Republika e Koresë dhe Singapori. Nëse keni pyetje apo shqetësime në lidhje me certifikimet tona të sistemeve CBPR të APEC-së ose PRP që nuk kanë marrë ende zgjidhje, kontaktoni [ofruerin tonë për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve me palët e treta](#).

Të dhënat personale që lidhen me individët në Republikën Popullore të Kinës mund të përpunohen nga Apple në vendet jashtë Republikës Popullore të Kinës, si p.sh. Apple Inc. në Shtetet e Bashkuara ose Apple Distribution International Limited në Republikën e Irlandës. Kur ndodh kjo, do të bëhet në përputhje me ligjet vendore, duke përfshirë ligjin për mbrojtjen e informacioneve personale. Për qëllimet e përpunimit të përcaktuara në këtë politikë të privatësisë, Apple mund t'i transferojë gjithashtu këto të dhëna personale tek ofruerit e tretë të shërbimeve, të cilët, nga ana e tyre, mund t'i ruajnë ose t'i transferojnë të dhënat jashtë Republikës Popullore të Kinës. Për më shumë informacione, vizitoni [Zbulimet e informacioneve për Kinën Kontinentale](#).

Përkushtimi i të gjithë kompanisë sonë për privatësinë tuaj

Për të garantuar sigurinë e të dhënave tuaja personale, ne ua komunikojmë udhëzimet tona të privatësisë dhe të sigurisë punonjësve të Apple dhe vëmë rreptësisht në zbatim masat përkatëse të privatësisë brenda kompanisë.

Pyetje rreth privatësisë

Nëse keni pyetje për politikën e privatësisë ose praktikën e privatësisë të Apple, mes të cilave dhe rastet kur një ofrues shërbimi i tretë vepron për llogarinë tonë, ose nëse dëshironi të kontaktoni përgjegjësin tonë për mbrojtjen e të dhënave, mund të na kontaktoni në apple.com/legal/privacy/contact ose të na telefononi në numrin e Mbështetjes së Apple për shtetin apo rajonin tuaj. Mund të na drejtoni pyetje edhe për mënyrën e depozitimit të një ankese në lidhje me privatësinë dhe ne do të përpiqemi t'ju ndihmojmë.

Apple i trajton me seriozitet pyetjet rreth privatësisë. Pyetjet dhe shqetësimet, duke përfshirë pyetjet e marra në përgjigje të një kërkesë për qasje apo shkarkim, shqyrtohen nga një ekip i dedikuar, në mënyrë që të përcaktohet se si mund t'u përgjigjemi më mirë. Në shumicën e rasteve, të gjitha kërkesat konfidenciale marrin përgjigje brenda shtatë ditësh. Në raste të tjera, ne mund të kërkojmë informacion shtesë ose t'ju informojmë se na nevojitet më shumë kohë për të dhënë një përgjigje.

Kur ankesa juaj tregon se mund të bëhet përmirësim në administrimin e problemeve të privatësisë, do të ndërmarim masa për ta kryer përditësimin në fjalë në rastin më të parë të arsyeshëm. Në rast se problemi i privatësisë ka sjellë pasoja negative për ju apo dikë tjetër, do të ndërmarim masa për t'i dhënë zgjidhje me ju apo me personin tjetër në fjalë.

Ankesën tuaj mund t'ia referoni në çdo kohë rregullatorit përkatës, duke përfshirë rastet kur nuk jeni të kënaqur me përgjigjen e marrë nga Apple. Nëse na pyesni, ne do të përpiqemi t'ju japim informacione rreth rrugëve përkatëse të ankimimit që mund të zbatohen në rrethanat tuaja.

Në rastin e një ndryshimi thelbësor në këtë Politikë të privatësisë, ne do të postojmë një njoftim në këtë uebsajt të paktën një javë përpara kryerjes së ndryshimit dhe, nëse i kemi të ruajtura të dhënat tuaja, do t'ju kontaktojmë drejtpërdrejt.

[Shikoni certifikimin tonë APEC CBPR >](#)

[Shikoni certifikimin tonë APEC PRP >](#)